



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 12 tetor 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Adem Grabovci dhe Albert Kinolli.

Munguan: Afrim Hoti, Bali Muharremaj.

Deputet të tjerë pjesëmarrës: Alma Lama

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON –auditor i përgjithshëm, Dardan Gashi- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Arben Gjuka –KEK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri- koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës) Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 28.09.2011.
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për importim, blerje vendore dhe shkëmbime të energjisë elektrike nga KEK-u gjatë vitit 2010.
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se ministri i ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka lajmëruar për pamundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e komisionit. Propozoi që pika tre e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Rendin e ditës me ndryshimin e propozuar.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 28 shtator 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 28 shtator 2011.

3 Shqyrtimi i raportit të auditimit për importim, blerje vendore dhe shkëmbime të energjisë elektrike nga KEK-u gjatë vitit 2010.

Kryetari – Sipas raportit mendimi është pozitiv, megjithatë ka nevojë për sqarimin e disa çështjeve në mënyrë që në të ardhmen ky raport të jetë edhe më i mirë. KEK-u ka pas 45 milion euro subvencione prej të cilave 5 milion nuk janë shpenzuar, përderisa ka pas reduktime të rrymës në atë periudhë. Kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Mospërmbajtja e afatit të pagesave ka pasur vonesa deri në 33 ditë, pastaj ndryshimi prej 15 mijë euro që përdoret për trajnime në ministri - kjo sipas auditorit është gabim teknik. Ka probleme të ndryshme të kodeve etj. Hap diskutimin.

Arben Gjuka – KEK- KEK është i kënaqur me përfundimet e ZAP-it dhe ka bërë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve. KEK-u subvencionin është munduar që në mënyrën më të mirë ekonomike ta shfrytëzoj. KEK-u është munduar që pjesën më të mirë të parave ta ruaj për sezonin e dimrit që quhet sezon i lartë, kur konsumatorët shpenzojnë energjinë për ngrohje.

Janë tri lloj kontratash: normale, kontratat për energjinë e moduluar ose e pikut (nga ora 7 deri në orën 23 në mbrëmje në atë kohë Kosova është vend importues. Natën ka teprica, sepse konsumi 63% është konsum amvisërie. Duhet ditur se Kosova është vendi i vetëm që punon pa rezervë që nënkupton që në rast të një defekti të një njësie KEK-u nuk ka rezervë ta kompensoj atë) Si dhe kontratat energji emergjente - energjia merret deri në tri orë në bazë të rregullave të tregut. KEK-u ka planifikuar se do të këtë më shumë defekte, por në fund të vitit ka ardhur në një kursim prej diku 4.5 milion euro.

Në vitin 2008 performanca apo energjia që nuk është dërguar deri te konsumatori ka qenë 16%, në vitin 2009 ka rënë në 8%, në 2010 3% , në vitin 2011 pritet të bie në 2%. Domethënë konsumatorët janë furnizuar në mënyrën më të mirë. Furnizimi bëhet në bazë të një plani që quhet A,B,C që nënkupton konsumatorët mirë pagues dhe mirë shfrytëzues.

Subvencionet të rastet sociale –qeveria i subvencionon rastet sociale, këto raste tani janë rritur 270kilovat që kanë qenë për familje ka rënë në 225 kilovat, sepse është rritur numri i skemës sociale. Këto para KEK-u i merr një vit pas.

Vonesa e pagesave- viti 2010 është ndryshe krahasuar me vitin 2009, sepse ka arritur me kohë të kryej obligimet. Nga viti i kaluar KEK –u ka bërë penalizmin e kontraktorëve, por ka edhe raste kur edhe kontraktorët kanë kërkuar përmbushjen e obligimit nga KEK-u.

Sali Bytyçi – KEK-u ka bërë një plan veprimi dhe thajse të gjitha rekomandimet që ka dhënë auditori janë adresuar, të gjeturat janë përmirësuar. Poashtu me këtë plan veprimi është caktuar koha se kur do të përfundojnë këto punë.

Çështja e kodeve- ka qenë një problem teknik – KEK-u ka një numër të madh të transaksioneve – problemi është në kontabilitet. Kjo çështje është përmirësuar.

Planifikimi i blerjes vendore të energjisë- është e komplikuar dhe problemi ka qenë se viti e kaluar ka pasur reshje të mëdha dhe ka pasur energji më të madhe se sa që ka paraparë KEK-u me bilanc energjetik. Kjo ka ndodhur edhe për arsye se KEK-u varet edhe prej bilancit energjetik në pjesën veriore dhe ky më tepër është problem politik.

Vonesa e pagesave – ka raste kur KEK-u ka kontratë sipas së cilës afati për pagesë është 30 ditë dhe KEK-u është vonuar në këtë. Kjo për arsye se fatura ose nuk ka përmbajtur elementet e përgjithshme që duhet t'i përmbajë ose nuk ka qenë pranimit teknik i energjisë. Operatorit i është kthyer fatura, ka bërë ndryshime dhe në të njëjtën kohë është bërë pagesa. Domethënë operatorët kanë qenë të informuar pse nuk është bërë pagesa dhe për këtë arsye nuk ka pasur penalti për ta.

Ramiz Lladrovci – Përgëzoi KEK-un për menaxhim të mirë të buxhetit. Raporti është i mirë dhe pyeti: KEK-u ka eksportuar energji elektrike, por ka larë borxh (Zvicrës). Për cilin borxh është fjala, apo për cilin vit është fjala?

Alma Lama – Raporti nuk sjellë një analizë të çmimeve me vendet e rajonit. Pyeti: si kanë qenë këto çmime? Janë në përputhje me çmimet e rajoni apo jo? Plani A,B,C – përbën diskriminim. Me këtë plan po diskriminohen ata që janë pagues të rregullt të rrymës ndërkohë favorizohen kompani që kanë miliona euro borxh KEK-ut. Deri kur do të vazhdoj kjo gjendje? Sipas raportit të ZAP-it, kontrolli i brendshëm nuk ka shumë besueshmëri të informacioneve që përmbajnë pasqyrat financiare. Kërkoj sqarim se ku janë gjetur këto parregullsi.

Valbona Dibra – Objektiva e auditorit ka qenë vetëm auditimi i subvencioneve nga Buxheti i Kosovës dhënë KEK-ut. Grandi i qeverisë është menaxhuar mirë nga KEK-u. Megjithatë, sipas Raportit të ZAP-it, KEK-u gjatë vitit 2010 nuk ka arritur që të siguroj energji të mjaftueshme për konsumatorët e vendit. Cilat janë pritjet për furnizim me energji elektrike gjatë këtyre dy muajve? A ka parashikuar KEK-u ndonjë avancim, furnizim më të mirë me energji elektrike?

Mursel Halilji – Pyeti: sa është përqindja e borxhit të qytetarëve? Pastaj borxhi që ka lindur në marrëveshjen në mes KEK-ut dhe RTK-së, për parapagimin e RTK-së, me vendim të Gjykatës Kushtetuese është pezulluar pagesa për RTK-në. Cilat janë kriteret me rastin e zvogëlimit të borxhit. Në regjionin e Komunës së Dragashit ekzistojnë shumë familje të cilat e kanë paguar vetëm shumën e energjisë elektrike. Kur është bërë zvogëlimi i pagesës në bazë të vendimit të Gjykatës disave kjo vlerë u është zvogëluar për 10 ose 20 euro, ndërsa disa të tjerëve për 100 euro. Domethënë ka paqartësi. Pse ka ndodhur kjo që disa llogari të zvogëlohen për 10 euro e disa për 100 euro? Cilat janë kriteret në bazë të të cilave ka vepruar KEK-u në këto raste? A do të ndërmerret diçka për barazimin e zvogëlimeve?

Adem Grabovci – Kategorizimin në A,B,C, zbatohet në kohën e Pik-ut, por që ka padrejtësi, kjo është evidente. Konsumatorët janë individual dhe kurrsesi nuk duhet të viktimizohet konsumatori i rregullt, sepse kjo ndikon në rritjen e konsumatorëve të kqinjë. Pra, ky problem duhet të zgjidhet në mënyrë individuale. A ka menduar KEK-u për ndonjë zgjidhje (plan) më të mirë që të zgjidhet ky problem?

Kryetari – Ka ekzistuar projekti që njësimi i energjisë elektrike të bëhet ndryshe. A ka KEK-u plane të tilla?

Ramiz Lladrovci –Nuk është diskriminim kategorizimi, sepse rryma është mall të cilin duhet paguar. Çmimi është më i shtrenjtë, sepse merret në kohën e Pik-ut. Pyeti: a ka mundësi të bëhet kontrata individuale me KEK-un me parapagim?

Armend Zemaj – Është për tu vlerësuar që subvencionimi i KEK-ut nga Qeveria nga viti në vit po reduktohet. Raporti nuk përmban vlerësim të menaxhimit të sistemit, por u interesua për shpenzimin e 45 milion eurove. A janë mbuluar kërkesat e qytetarëve? Ka 5 lloj kontratash dhe a është e mundur që brenda një kontrate KEK-u ka këto module apo janë kontrata të veçanta? Si ndërtohet një kontratë? Nëpër fshatra ka qkycje kolektive kjo është evidente dhe faktikisht diskriminohet ai që është pagues i rregullt. Pyeti: a ka tarifë të caktuar për rastet sociale apo kjo bëhet në mënyrë paushalle? Kërkoj sqarim lidhur me nivelin e lartë të humbjeve të akumuluar që ka qenë rekomandim nga viti 2009?

Albert Kinolli – Sipas raportit KEK-u është subvencionuar nga qeveria. Këto janë para të taksapaguesve për të cilat duhet të marrin shërbime sa më cilësore. Po ashtu sipas raportit këto mjete nuk janë shpenzuar aq sa duhet dhe ka pasur reduktime. Kosova ka importuar vetëm 13% të rrymës krahasuar me shtetet e tjera. Pyeti: a nën kupton kjo që s'ka pas nevojë për import më shumë edhe pse ka pas reduktime?

Pati vërejte për përfaqësimin e komunitetit romë në KEK. Ka raste që është ndërprerë kontrata pa asnjë arsye. Ka pas raste kur njerëzit e një komuniteti në një lagje kanë mbet pa rrymë për shkak të një shtylle. Prindërit e tyre janë taksapagues të Kosovës.

Arben Gjuka – Para vitit 2006, tregu i Evropës Juglindore më shumë është ballafaquar me shkëmbimet. Kjo në kupton se më herët Kosova natën ka plasuar, jo eksportuar teprica. Këto teprica janë shkëmbyer me operator të ndryshëm një prej tyre është Zvicra dhe në kuadër të kësaj KEK-u ka mbetur borxh. Por, nga viti 2006 më nuk bëhen shkëmbime –përgjashtim me shtetin shqiptarë. Ka borxhe ndaj disa kompanive pasi që janë ndërprerë shkëmbimet. Plasimet bëhen në bazë të kontratave komerciale duke marrë për bazë rregullat e prokurimit publik.

Kosova merr energji në kohë të PIKUT dhe nuk merr energjinë si shtetet tjera. Kosova merr energji bazike. Kosova A dhe B janë në fazën e fundit të jetëgjatësisë. Nëse bëhen krahasimet e çmimeve të kohës kur merret energjia, Kosova merr energji me çmime të tregut dhe kjo domethënë më çmimin e njëjtë me shtetet e tjera. Shqipëria importon 45%, Maqedonia 38%, Serbia mbi 20%. Kosova importon 13%-15%. Çmimet janë të tregut dhe janë të krahasueshme me rajonin.

Auditori i brendshëm i përgjigjet Bordit të drejtorëve e jo menaxhmentit.

Momentalisht janë në dispozicion tri njësi të Kosovës A, dy janë në disponueshmëri afër 85%. Momentalisht janë kryer remonti i njësisë B1 që ka përfunduar në fund të muajit gusht dhe është një remont i njësisë B2 që do të përfundoj me datën 27 nëntor. Disponueshmëria e këtyre blloqeve do të rritet. Këtë vit është planifikuar import me ndihmën e qeverisë deri në muajin mars. Operimi i KEK-ut do të ishte shumë më i lehtë nëse ngrohoret e qytetit do të punonin.

Kategorizimi A,B,C nuk është diskriminim dhe nuk ka informacione nëse ka raste të tilla. Kjo skemë zbatohet vetëm në kohën e Pik-ut dhe ndërron vazhdimisht çdo datë 15. Kjo është shumë transparente, është e digjitalizuar dhe çdo konsumator ka qasje në të. Kriteria për kategorizimi janë dy kushte: kushti i pagesës dhe kushti i mirë-shfrytëzimit.

KEK - u ka ndarë borxhin e RTK-së të cilën kanë pasur klientët dhe atë do ta kërkoj RTK-ja. Domethënë fatura është ndarë dhe secila shtëpi është njoftuar me borxhin që ka ndaj RTK-së dhe ndaj KEK-ut.

Qkyqjet KEK-u i bënë në mënyrë individuale dhe bënë mbi 25mijë qkyqje në muaj. Kur ekipet pengohen në zona të caktuara dhe në zonat ku ka rikyqje ilegale, atëherë fjala është për vepër penale. Në të gjitha këto raste KEK-u i drejtohet gjykatës. Deri më tani ka vetëm një rast të një lirimi me kush lidhur me këtë. Domethënë nuk ka efekte, përkatësisht vendime të tjera të Gjykatës.

Ndërrimi i të gjithë “njësorëve të mençur” ka koston 140milion euro dhe në pamundësi për të përballuar këtë shumë KEK-u ka bërë një ndarje. Së pari janë vendosur njësorët në të gjitha pikat kyçe të sistemit distributiv, pastaj këta njësor janë vendosur te të gjithë konsumatorët komercial dhe janë duke u vendosur te të gjitha daljet drejt 04-it. Çdo ndryshim i njësorëve tani e tutje kusht është që njësori të jetë digjital.

Kontrata me parapagim - mund të bëhet vetëm për biznese. Jo për konsumatorë individual. Projekti ka qenë më herët, por ka dështuar. Gjendja e sistemit distributiv nuk është e mirë. Vitin e kaluar është bërë një investim 20milion euro në sistemin shpërndarës.

Format e kontratës - bëhen në bazë të LPP edhe pse asnjë vend në botë nuk e bënë në këtë mënyrë, sepse ngjarjet me rrymë janë të paparashikuara. Ka dy vite që bëhet në kontrata afatgjate.

Rastet sociale- tarifa ka qenë 270 kilovat për muaj në këtë vit ka rënë në 225 kilovatë. Dhe në momentin që tejkalohet kjo atëherë KEK-u qkyq konsumatorin.

Prodhimi është rrit për 6% dhe ka arritur ta mbaj importin në atë sasi. Është dashur të importohet më shumë dhe mbulueshmëria ka arrit 87% nga prodhimi vendor ndërsa 13% është importuar dhe 3% ka mbet e pambuluar në kohë të caktuar. Ka raste kur mjetet ekzistojnë por për shkak të mjeteve teknike nuk arrihet mbulueshmëria totale. Sa i përket punësimin kjo bëhet sipas ligjit dhe konkursit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Raporti i auditimit për importim, blerje vendore dhe shkëmbime të energjisë elektrike nga KEK-u gjatë vitit 2010, nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

4. Të ndryshme

a) Fushëveprimtaria e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se Nënkomisioni për mandate, imunitete dhe rregullore të Kuvendit, ka rekomanduar që Komisionet të shqyrtojnë fushëveprimtarinë e tyre dhe brenda afatit prej dy javësh ta procedojnë te ky komision versionin final të fushëveprimtarisë së Komisionit. Materiali lidhur me këtë ju është shpërndarë dhe kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit.

Armend Zemaj – Propozoi që në kuadër të fushëveprimtarisë së Komisionit të përfshihet edhe mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve nga organizatat buxhetore.

Valbona Dibra – Propozoi që Komisioni të shqyrtoj fushëveprimin e tij në mbledhjen e radhës të komisionit, në mënyrë që deputetët të dalin me propozime konkrete.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Shqyrtimi i fushëveprimtarisë së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, do të vazhdoj në mbledhjen e radhës të Komisionit, ku anëtarët e Komisionit do të dalin me propozime konkrete.

b) Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të ART-së, për vitin 2010

Kryetari - Komisioni ka shqyrtuar këtë raport, por nuk ka dal me një përfundim. Komisioni i ka dhënë mundësin ZAP-it dhe ART-së që të sjellin dëshmi dhe të harmonizojnë qëndrimet rreth të gjeturave të ZAP-it. Komisioni nuk ka pranuar me shkrim asgjë, përveç dy takimeve të ndara që kam pasur me këto dy institucione me kryetarin e Komisionit. ART dhe ZAP-i kanë sjell dokumente ndaras të cilat i janë dorëzuar anëtarëve të Komisionit, por duhet marr vendim lidhur me këtë.

Ramiz Lladrovci – Komisioni ka kërkuar që ZAP-i dhe ART të takohen dhe të gjejnë zgjidhje rreth kundërshtimeve që kanë pasur rreth të gjeturave të ZAP-it. ZAP-i është i pavarur në punën e tij por përgjigjet para këtij Komisioni.

Kësaj duhet bashkangjitur edhe vërejtja për ZAP-in, lidhur me opinionin për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Kërkoi përgjigje nga ZAP-i, nëse opinionin i dhënë është politik apo është marrë vendim në marrëveshje me njerëz të caktuar?

Armend Zemaj – Lidhur me raportin e ART-së duhet menduar seriozisht se si do ti qaset Komisioni. Kjo për arsye se pikërisht për njërën nga çështjet e prokurimit, për të cilën është debatuar në Komision, gjykata ka vendosur në favor të ART-së. Dhe përfaqësuesi i ART-së ka kundërshtuar këtë të gjetur të ZAP-it, para Komisionit.

Pastaj, është praktike e komisionit që raportet me opinion te pakualifikuar te mos procedohen ne mbledhje plenare dhe gjate shqyrtimit shihet qe ka raste kur ka një opinion te tillë, ndërsa te gjeturat janë shume serioze. ZAP-i duhet ta ketë parasysh këtë shqetësim të Komisionit.

Adem Grabovci – Tha se vendimet e Gjykatës bien në kundërshtim me Raportin e ZAP-it, prandaj ky problem duhet zgjidhur në mes ART-së dhe ZAP-it. Komisioni është i interesuar të mësoj të vërtetën dhe do t'a bëjë këtë.

Kryetari – Kësaj duhet shtuar opinionin për Ministrinë e pushtetit lokal. Komisioni ka qenë i kënaqur me këtë ministri dhe opinionin me theksim të çështjes është i pa vend.

Valbona Dibra - Tha se Komisioni nuk duhet të kërkoj ndryshimin e opinionit, sepse mund të konsiderohet si cenim i pavarësisë së ZAP-it. Auditorët përdorin standardet ndërkombëtare të auditimit.

Ramiz Lladrovci -Tha se Komisioni nuk po ndërhyr në pavarësinë e ZAP-it por, opinionin i dhënë për Ministrinë e kthimit është i papranueshëm për Komisionin kjo në bazë të gjeturave që përmban ky raport.

Ibrahim Gjylderren, zv.auditor i përgjithshëm - Tha se ZAP-i ka filluar një auditim të ri të ART-së për vitin 2011 dhe në atë auditim do të përfshihen edhe të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet nga viti i kaluar. Sa i përket opinionit kjo jepet për pasqyrat financiare të prezantuara p.sh për një transaksion, por kjo nuk do të thotë që transaksioni është bërë në mënyrë të rregullt.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

- *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të njoftoj Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike për hapat e ndërmarrë rreth Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të ART-së, për vitin 2010.*
- *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të shikoj nëse ekziston arsye për ndërrim të opinionit për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe për Ministrinë e Pushtetit Lokal.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu